




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit

Opština Gnjilane

Municipality of Gjilan

Gjilan Belediyesi

**STATUTI I GALERISË SË ARTEVE
NË GJILAN
“Galeria e Arteve-Gjilan”**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2., pika “d)”, neni 17, pika “r)” dhe “s” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), neni 2, neni 12, paragrafi 12.2 dhe 12.5, neni 32, 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Institucionet e Kulturës nr. 02/L-57 v (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 11 2007) si dhe neni 38 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. Nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 04.08.2023, miratoi:

Statuti e Galerisë së Arteve në Gjilan

Neni 1

Qëllimi

Me këtë statut përcaktohet statusi juridik i Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” në Gjilan, themelimi, veprimtaria, natyra e punës, konstituimi dhe funksionimi i organeve drejtuese, mënyra e zgjedhjes së tyre, detyrat, vendimmartja dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Galerisë si dhe mënyra e financimit.

Neni 2

**Themelimi, veprimtaria, struktura, organizimi dhe funksionimi i Galerisë së Arteve
“Galeria e Arteve-Gjilan” në Gjilan**

1. Themeluese i Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” në Gjilan është Kuvendi i Komunës së Gjilanit.
2. Galeria e Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” është institucion në pronësi publike dhe regjistrohët në regjistrin e institucioneve publike të kulturës.
3. Galeria ka xhironlogarinë e vet në njëërën nga bankat e licencuara në Republikën e Kosovës.
4. Galeria e Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” është person juridik të cilin në raport me palët e tjera e përfaqëson Drejtori i Galerisë.

Neni 3

Emërtimi, selia, vula, simbolet dhe logo

1. Emërtimi zyrtar i institucionit është "Galeria e Arteve-Gjilan".
2. Emërtimi i Galerisë së Arteve është bërë me vendimin e Kuvendit të Komunës 01 Nr. 88 të datës 25.05.2023.
3. Akronimi i Galerisë së Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" në Gjilan është GA-GJ.
4. Galeria ka selinë në Gjilan, rr. "Xheme Tupalla" pn. Objekti i Teatrit të Qytetit në Gjilan.
5. Në hyrje të objektit të Galerisë vendoset mbishkrimi në gjuhët zyrtare, të cilat parashihen me Ligjin për Gjuhët Zyrtare të Republikës së Kosovës.
6. Galeria ka vulën e rrumbullakët dhe katrore.
 7. Vula e rrumbullakët është me diametër 3 cm dhe ka këtë përmbajtje:
 - 7.1. Republika e Kosovës – Komuna e Gjilanit;
 - 7.2. Galeria e Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan";
 - 7.3. Në mes e ka logon e institucionit;
 8. Vula katrore e institucionit për pranimin dhe dorëzimin e shkrësave është e madhësisë 6 x 3.7cm dhe ka këtë përmbajtje:
 - 8.1. Galeria e Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe;
 - 8.2. Nr. Referencës/protokolit;
 - 8.3. Data;
 - 8.4. Nënshkrimi;

8.5. Logoja e Galerisë;

9. Galeria e Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" ka logon dhe simbolat e saja dalluese nga institucionet tjera.

10. Ndryshimi, freskimi, modifikimi i logos dhe simboleve bëhet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues të Galerisë së Arteve.

Neni 4

Veprimtaria

1. Veprimtaria e Galerisë përfshinë:

- 1.1. Përgatitjen dhe publikimin e ekspozitave;
- 1.2. Publikimet;
- 1.3. Edukimin;
- 1.4. Huluminimin;
- 1.5. Mëhaxhimin dhe pasurimin e fondit/koleksionit të Galerisë së Arteve në Gjilan;
- 1.6. Veprimtarië ekonomike që lidhen me natyrën e veprimtariës së Galerisë.
- 1.7.
 2. Galeria nxitë, zhvillon, avancoon, publikoon dhe promovoon artin pamor në vend dhe jashtë vendit përmes:
 - 2.1. Hartimit të politikave dhe propozimit të masave për ngritjen e cilësisë profesionale në fushën e artit pamor;
 - 2.2. Shkëmbimeve artistike, punëtorive, ekspozitave;
 - 2.3. Publikimeve, monografive, katalogëve dhe materialeve të tjera promovuese të botuara apo edhe vizuale në sferën e artit dhe kulturës;
 - 2.4. Programit të edukimit me fëmijët dhe kategoritë tjera sociale, trajnimeve dhe debateve në fushën e artit, kulturës dhe bibliotekës.
 - 2.5. Hulumimeve në sferën e artit dhe kulturës;

- 2.6. Mbledhjes, blerjes, ruajtjes dhe restaurimit të koleksionit të Galerisë së Arteve në Gjilan dhe promovimit të tij;
- 2.7. Informimit publik përmes mediave dhe formave të tjera të komunikimit dhe informimit publik;

Neni 5

Ruajtja e dokumentacionit dhe materialeve

1. Galeria e Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" obligohet që të ruaj, promovoj dhe sistemoj materialet në kuadër të koleksionit të Galerisë së Arteve në Gjilan dhe materialeve të tjera me rëndësi për institucionin, sipas Ligjit për Arkivat e Kosovës.
2. Ruajtja e dokumentacionit dhe materialeve, përfshinë por nuk kufizohet vetëm në ruajtjen e vulës, dokumentacionit, mjeteve të punës, rekuizitat, koleksionit të Galerisë së Arteve në Gjilan dhe pasuritë tjera të Galerisë.
3. Dokumentacioni i Galerisë ruhet në vende përkatëse në përputhje të plotë me Ligjin për ruajtjen e materialit arkivor dhe standardet bashkëkohore.

Neni 6

Organizimi i brendshëm

1. Galeria e Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" është institucion publik në vartësi të Komunës së Gjilanit, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Veprimtaria e Galerisë realizohet përmes ndarjes në sektorë :
 - 2.1. Sektori i Publikimeve dhe Promovimit;
 - 2.2. Sektori i Edukimit dhe Hulumtimit;
 - 2.3. Sektori i Marrëdhënieve me Publikun;
 - 2.4. Sektori Teknik-Profesional;
 - 2.5. Sektori Administrativ-Financiar;
 - 2.6. Sektori i Koleksionit të Galerisë së Arteve në Gjilan;

Neni 7
Organet drejtuese të Galerisë

Organet drejtuese të Galerisë janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtori

Neni 8

Mandati i Këshillit Drejtues të Galerisë

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë drejtues i Galerisë;
2. Këshilli Drejtues aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të Galerisë duke përfshirë politikën kulturore, artistike dhe strukturën organizative;
3. Këshilli Drejtues aprovon buxhetin dhe programin vjetor të Galerisë si dhe ka qasje në dokumentacionin e rregullt dhe pasqyrat financiare të institucionit.
4. Këshilli Drejtues zgjedh Drejtorin e Galerisë;
5. Këshilli Drejtues së paku një herë në vit kërkon nga themeluesi, Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që në funksion të përmbytjes së llogaridhënies të bëjë auditimin e pavarur të institucionit;
6. Këshilli Drejtues bën vlerësimin e punës së Drejtorit të Galerisë dhe raporton tek Kryetari i Komunës për punën e tij dhe të Galerisë në përgjithësi.
7. Këshilli Drejtues propozon tek themeluesi i institucionit, ndërrimin e veprimtarisë apo zgjerimin e saj.

8. Këshilli Drejtues i Galerisë nxjerr vendime dhe akte të tjera nënligjore për mbarëvajtjen e punës së Galerisë, bazuar në legjislaçionin në fuqi, aktin e themelimit dhe këtë Statut.

Neni 9

Përberja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i Galerisë së Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" përbëhet nga 5 anëtarë.
2. Emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Galerisë e bën Kryetari i Komunës me vendim të veçantë.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Galerisë së Arteve "Galeria e Arteve-Gjilan" duhet të jenë personalitete të dëshmuara në fusha të ndryshme si art, kulturë, rini dhe arsim.
4. Këshilli Drejtues i Galerisë i raporton së paku një herë në vit, Kryetarit të Komunës.
5. Këshilli Drejtues i Galerisë zgjidhet me mandate 4 vjeçar me mundësinë e rizgjedhjes edhe për një mandat.
6. Punën e Këshillit Drejtues të Galerisë e udhëheq Kryetari i Këshillit Drejtues, i cili zgjidhet nga radhët e Këshillit me shumicën e votave të fshehta të anëtarëve të Këshillit.
7. Shkarkimi i Kryetarit të Këshillit Drejtues të Galerisë bëhet me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 10

Funksionimi i Këshillit

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues të Galerisë i thirr dhe i udhëheq Kryetari i Këshillit Drejtues të Galerisë.
Mbledhjet e Këshillit Drejtues të Galerisë, ftohen edhe me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

2. Në mungesë të Kryetarit të Këshillit, mbledhjet e Këshillit Drejtues të Galerisë mund t'i udhëheq edhe njëri nga anëtarët e Këshillit të cilin paraprakisht e cakton Kryetari i Këshillit.
3. Këshilli Drejtues i Galerisë mund të punoj nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e anëtarëve të Këshillit.
4. Vendimet e rëndësishme të Këshillit Drejtues të Galerisë si: ndryshimi i Statutit, shkarkimi i Drejtorit të Galerisë, aprovimi i programit vjetor të punës dhe buxheti si dhe raporti vjetor merret me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit.
5. Këshilli Drejtues i Galerisë për punën e tyre i përgjigjen dhe raportojnë Kryetarit të Komunes.

Neni 11

Kompenzimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Galerisë

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Galerisë kompenzohen për punën e tyre për secilin mbledhje të mbajtur gjatë vitit por nuk mund të kompenzohen për më shumë se 12 mbledhje në vit.
2. Paguesa do të bëhet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunes apo drejtorisë përkatëse. Dëshmi për pagesë do të jetë lista e pjesëmarrjes për mbledhjen e mbajtur të Këshillit Drejtues.

Neni 12

Drejtori i Galerisë

Drejtori i Galerisë është udhëheqës i Galerisë dhe organ ekzekutiv i tij i cili ka këto autorizime dhe përgjegjësi:

1. Udhëheq punën e Galerisë;
2. Përfaqëson brenda dhe jashtë vendit Galerinë;
3. Propozon programin vjetor të punës së Galerisë të cilin e miraton Këshilli Drejtues;
4. Zbaton programin vjetor të punës së Galerisë dhe vendimet e Këshillit Drejtues të Galerisë;

5. Mblidhëqyr dhe vlerëson punën e personelit të angazhuar në Galerinë e Arteve;
6. I propozon Këshillit Drejtues, buxheut vjetor të Galerisë;
7. Kërkon, aplikon dhe negocion marrjen e donacioneve;
8. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Galerisë dhe komisione, pa të drejtë vote;
9. Në baza mujore dhe vjetore, i raporton Këshillit Drejtues, për punën e performancën e Galerisë së Arteve;
10. Përgjigjet për veprimtarinë financiare dhe juridike të Galerisë.

Neni 13

Zgjedhja e Drejtorit të Galerisë

1. Drejtorin e Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli Drejtues i Galerisë në bazë të procedurave të konkursit publik të shpallur nga vet Këshilli Drejtues.
2. Procedura për emërimin, zgjedhjen e Drejtorit të Galerisë bazohet në Ligjin për Institucionet e Kulturës dhe në Ligjin për Zyrtar Publik.
3. Për Drejtor të Galerisë së Arteve zgjedhet personi me përgatitje universitare me përvojë së paku pesë vjeçarë në pozita menaxhuese në fushën e artit dhe kulturës.
4. Drejtori i Galerisë zgjedhet me mandate prej katër (4) vitesh me mundësi rizgjedhjes.
5. Drejtorin e shkarkon Këshilli Drejtues i Galerisë me 2/3 e votave duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Në rast të shkarkimit të Drejtorit të Galerisë, Këshilli Drejtues emëron Ushtruesin e Detyrës me shumicën absolute të votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues, me informim paraprak të Kryetarit të Komunes.

Neni 14

Financimi

Mjetet financiare për punën e Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” sigurohen nga:

1. Buxheti i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
2. Të hyrat vetanake, sponsorizimet, donacionet, dhuratat, dhe të hyrat tjera.

Neni 15
Auditimi

Auditimin e pasqyrave financiare të Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” e bën auditori i brendshëm dhe i jashtëm sipas nevojës.

Neni 16
Pasuria e Galerisë

1. Pasuria e Galerisë është pasuria e luajshme dhe e paluajshme që e ka krijuar dhe ka në pronësi institucioni;
2. Koleksioni i Galerisë së Arteve në Komunën e Gjilanit është fondi i veprave artistike të cilat i posedon Galeria;
3. Galeria e Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” nuk mund të tjetërsoj pasurinë e saj pa pëlqimin paraprak të Kuvendi të Komunës, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 17
Shpërbërja e Galerisë

Shpërbërjen e Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” e bën themeluesi, Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 18
Dispozita kalimtare

1. Statutin e Galerisë e nxjerr Këshilli Drejtues i Galerisë ndërsa e miraton Kuvendi i Komunës.

2. Këshilli Drejtues i Galerisë është i obliguar që të nxjerr edhe akte të tjera juridike të parapara me këtë Statut në afatën prej gjashtë muajsh nga dita e aprovimit të Statutit, siç janë:
- 2.1. Rregullorja e Punës së Galerisë së Arteve “Galeria e Arteve-Gjilan” në Komunën e Gjilanit;
 - 2.2. Rregulloren mbi Koleksionin e Galerisë së Arteve në Gjilan si dhe
 - 2.3. Rregullore e akte të tjera juridike për mbarëvajtjen e punës së institucionit.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Statut hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe shtatë ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në faqen zyrtare të Komunës.

01.Nr.016-82508

Gjilan, më 04.08.2023



Kryesuesi i KK Gjilan

/Kushtrim Kadriu/